WWRO

WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

PLANI I PUNËS 2009

Janar 2009

Vizioni

"Shërbime cilësore, të sigurta, dhe efiçente të ujit dhe mbeturinave për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën."

Misioni

"Rregullimi i shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave të ngurta në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave japin shërbime kualitative, të qëndrueshme, të besueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrotjen e shëndetit publik."

Përmbajtja:

Akronimet **4**

1. Hyrje **5**

2. Themelimi dhe Përgjegjësitë e ZRRUM **6**

3. Parimet Udhëheqëse të Punës së ZRRUM **7**

4. Struktura Organizative dhe Departamentet e ZRRUM **8**

5. Synimet Operative të ZRRUM **11**

6. Aktivitetet e Planifikuara dhe Indikatorët e Matshëm **16**

Akronimet

- **AKMM** — **Agjencioni Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit**
- **ART** — **Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**
- **ECLO** — **Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian**
- **ERRU** — **Enti Rregullator i Ujit të Shqipërisë**
- **IKSHPK** — **Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës**
- **IRAR** — **Rregullatori Ekonomik i Ujit dhe mBeturinave në Portugali**
- **KKK** — **Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve**
- **KLMC** — **Kompania për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave**
- **KRM** — **Kompanitë Regjionale të Mbeturinave**
- **KRR** — **Kontabiliteti Rregullator**
- **KRU** — **Kompanitë Regjionale të Ujit**
- **MMPH** — **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë**
- **PAMKOS** — **Shoqata e Kompanive të Mbeturinave të Kosovës**
- **PMA** — **Plani i Menaxhimit të Aseteve**
- **SDC** — **Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë**
- **SHUKOS** — **Shoqata e Kompanive të Ujësjellësit të Kosovës**
- **WICS** — **Autoriteti Rregullator i Ujit në Skotlandë**
- **ZRRE** — **Zyra e Rregullatorit të Energjisë**

1. Hyrje

Ky Plan i Punës paraqet prioritetet e Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) dhe përmbledh aktivitetet e planifikuara për realizimin e synimeve operative të përcaktuara për vitin 2009. Poashtu, i njëjti përcakton edhe treguesit e matshëm si dhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara.

Me *Rregulloren 2004/49* përmes të cilës është themeluar ZRRUM dhe janë përcaktuar përgjegjësitë ligjore të tij, dhe me amendamentimet e bëra të kësaj Rregulloreje me *Ligjin Nr. 03/L-086*, nuk përshkruhet në mënyrë specifike obligimi i ZRRUM-it për përgatitjen e Planit të Punës dhe Biznes Planit. Megjithatë për qëllime operative të definimit dhe mbikqyrjes së përmbushjes së objektivave dhe prioriteteve të punës, është përpiluar ky plan dhe i njëjti do të shërbejë si bazë për organizimin e aktiviteteteve të ZRRUM-it për vitin 2009.

Ky plan i punës është mbështetur në Planin Strategjik 2009-11 dhe në objektivat strategjikë të përcaktuara për këtë periudhë kohore.

Duke qenë të vetëdijshëm se mund të këtë zhvillime të reja lidhur me mandatin dhe përgjegjësitë ligjore të ZRRUM-it me ndryshimet eventuale të kuadrit ligjor, ky Plan i Punës është një dokument që do të rishikohet dhe të evoluojë vazhdimisht. Sidoqoftë, i njëjti reflekton prioritetet dhe aktivitetet e planifikuara të ZRRUM-it ashtu siç janë përcaktuar në dhjetor 2008.

2. Themelimi dhe Përgjegjësitë e ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) është rregullator ekonomik i sektorëve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë që është themeluar më 26 Nëntor të vitit 2004 me **Rregulloren 2004/49** në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Kjo Rregullore është amendamentuar me **Ligjin Nr. 03/L-086** të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më datë 13 Qershor 2008.

ZRRUM është përgjegjës për rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave, dhe deponimit të mbeturinave.

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUM janë:

- Përcaktimi i tarifave që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve,
- Lëshimi i licencave për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave,
- Nxitja e konkurrencës në sektorët e ujit dhe mbeturinave përmes krahasimit të performancës ("benchmarking"),
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e monopolit dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit,
- Monitorimi dhe raportimi i performancës së ofruesve të shërbimeve,
- Themelimi dhe përkrahja e këshillave konsultative për konsumatorë,
- Miratimi i kushteve për falje dhe shlyerje të borxheve nga e kaluara.

Pra, ZRRUM është përgjegjës për të siguruar se ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë iu ofrojnë konsumatorëve shërbime efiçente dhe cilësore me çmim të arsyeshëm dhe korrekt.

Në përmbushjen e përgjegjësive të veta rregullatore, ZRRUM udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Rregulloren 2004/49 dhe Ligjin Nr. 03/L-086 dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorët e ujit dhe mbeturinave. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është dhënë me legjislacionin sekundar (në formën e 14 Rregullave) të nxjerrë nga ZRRUM në Janar të vitit 2005 dhe të amendamentuar kohëpaskohe.

ZRRUM si rregullator i pavarur i sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë i përgjigjet për punën e vet Kuvendit të Kosovës. Deri në aprovimin e Ligjit Nr. 03/L-086 më 13 qershor 2008, ZRRUM i është përgjigjur Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara.

3. Parimet Udhëheqëse të Punës së ZRRUM

Parimet me të cilat udhëhiqet ZRRUM në punën e vet, për ti përmbushur misionin dhe objektivat strategjik, janë:

- Balancimi: Përcaktimi i tarifave të balancuara të shërbimit të cilat:
  - U mundësojnë kompanive të licencuara të ujësjellësit dhe mbeturinave që të ofrojnë shërbimet në përputhje me standardet dhe kërkesat relevante;
  - Marrin parasysh mundësitë paguese të popullatës.

- Objektiviteti: Monitorimi efektiv si dhe vlerësimi objektiv dhe transparent i punës së kompanive të licencuara duke bërë krahasime të duhura në baza vjetore për performancën e tyre;

- Mbrojtja e interesave të Konsumatorëve: Trajtimi i kontesteve dhe ankesave të konsumatorëve në mënyrë efektive dhe të drejtë dhe duke involvuar kompanitë e licencuara në këtë proces;

- Konsultimi:
  - Konsultimi me palët e interesit për të siguruar njohuri për pikëpamjet dhe prioritetet e palëve të interesit përmes shkëmbimit të informatave, memorandumeve të bashkëpunimit, mbajtjes së workshopeve të hapura, publikimit të raporteve relevante në web-faqen e vet, dhe përmes shtatë Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve;
  - Ofrimi i këshillave për hartimin dhe rishikimin e politikave (si p.sh. lidhur me de-rregullimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave);

- Transparenca: Publikimi i informatave në mënyrë të hapur dhe transparente dhe me këtë iu mundësohet të gjitha palëve të interesit që të kuptojnë dhe participojnë në vendimet rregullatore të cilat i merr ZRRUM-i;

- Bashkëpunimi:
  - Bashkëpunimi me rregullatorët tjerë të sektorit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë (siq janë MMPH dhe IKSHPK) për tu siguruar se përgjegjësitë e palëve të ndryshme janë të përkufizuara qartë;
  - Bashkëpunimi i ngushtë me rregullatorët tjerë ekonomik të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në regjion dhe në Europë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe aplikimit të praktikave më të mira;

- Mos-diskriminimi:
  - Sigurimi se tarifat e shërbimit me të cilat ngarkohen konsumatorët janë të drejta dhe nuk bëjnë diskriminim apo demonstrojnë preferenca për cilëndo kategori të konsumatorëve;
  - Sigurimi se ofrimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave bëhet në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese dhe se çështjet gjinore dhe të minoriteteve janë të adresuara në pajtim të plotë me ligjet e Kosovës;

4. Struktura Organizative dhe Departamentet e ZRRUM

Në përputhje me Rregulloren 2004/49 dhe Ligjin Nr. 03/L-086, ZRRUM udhëhiqet nga Drejtori dhe Zv. Drejtori si persona përgjegjës për funksionimin e Zyrës si dhe për marrjen e vendimeve rregullatore.

(i) Struktura Organizative

Me qëllim të operimit efiçent, efektiv dhe me kohë, ZRRUM ka aprovuar strukturën organizative të organizimit sipas të cilës departamentet e ZRRUM-it i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUM-it.

ZRRUM përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet regullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore, Seksioni i Performansës, dhe Seksioni për Ligj dhe Licenca, ndërkaq përgjegjës për mbështetjen e biznesit të ZRRUM-it është Seksioni për Administratë dhe Financa.

Struktura organizative e ZRRUM-it është dhënë në vijim:



(ii) Departamentet e ZRRUM

Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore

Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore i ofron mbështetje të nevojshme Drejtorit të ZRRUM-it në përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve.

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të këtij Seksioni përfshijnë:

- zhvillimin e metodologjisë dhe modeleve për llogaritjen tarifave të shërbimit,
- zhvillimin e praktikave dhe procedurave për aplikimin dhe shqyrtim të aplikacioneve për tarifa të shërbimit,
- udhëheqjen e procesit të përcaktimit të tarifave në frymën dispozitave ligjore në fuqi,
- shqyrtimin dhe evaluimin e të dhënave financiare nga raportet e kompanive të licencuara,
- auditimin e të dhënave financiare të kompanive të licencuara, dhe
- mbështetjen në hartimin e legjislacionit sekondar të ZRRUM-it.

Seksioni i Monitorimit të Performansës

Roli i Seksionit të Monitorimit të Performansës është që të organizojë sistemin e raportimit të kompanive të licencuara te ZRRUM-i dhe të përkujdeset për funksionimin e këtij sistemi. Në mënyrë të veçantë ky Seksion ka përgjegjësi për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të raportuara dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore lidhur me performansën operative dhe financiare të ofruesve të licencuar të shërbimit.

Poashtu, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të Seksionit të Monitorimit të Performansës përfshihen edhe aspektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve (bashkëpunimi me dhe mbështetja e punës së Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, shqyrtimi i aplikacioneve lidhur me shkyçjet kolektive, vlerësimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit etj.).

Seksioni i Çështjeve Ligjore dhe Licencimit

Seksioni i Çështjeve Ligjore dhe Licencimit i ofron mbështetje të nevojshme ligjore Drejtorit dhe stafit të ZRRUM-it në lidhje me aktivitetetet e ZRRUM-it dhe përfaqëson Zyrën në të gjitha seancat administrative dhe gjyqësore para autoriteteve administrative, instancave të arbitrimit, dhe gjykatave të Kosovës.

Ky Seksion poashtu është përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e praktikave dhe procedurave të licencimit si dhe udhëheqë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e licencimit të kompanive që janë nën mandatin rregullator të ZRRUM-it.

Seksioni i Administratës dhe Financave të ZRRUM-it

Seksioni i Administratës dhe Finanacave është përgjegjës për funksionimin administrativ dhe financiar të ZRRUM-it. Ky Seksion i ofron mbështetje administrative, gjuhësore, të menaxhimit të të dhënave, dhe të mbikqyrjes së financave të brendshme për Drejtorin dhe stafin e ZRRUM-it.

Poashtu ky Seksion menaxhon prokurimin, procesin e buxhetimit, resurset njerëzore, dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me objektin administrativ dhe automjetet e ZRRUM-it.

5. Synimet Operative të ZRRUM

Synimet operative të ZRRUM për vitin 2009 dalin nga objektivat strategjikë të përcaktuara me Planin Strategjik 2009-2011 dhe njëkohësisht bazohen në zhvillimet dhe arritjet e viteve të fundit.

Synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë të shoqëruara me veprime specifike të cilat planifikohen të ndërmirren për arritjen e synimeve përkatëse si dhe me indikatorë të matshëm për secilin veprim. Përmbushja ose mospërmbushja e synimeve respektive do të vlerësohet në bazë të indikatorëve të matshëm, dhe varësisht prej zhvillimeve do të rishikohet edhe ky plan i veprimit.

Veprimet specifike të planifikuara bashkë me indikatorët e matshëm janë paraqitur në kapitullin 6 duke u bazuar në synimet e përcaktuara për vitin 2009 si vijon:

Synimi 1:

Përforcimi i pavarësisë operative dhe financiare të ZRRUM si rregullator i pavarur ekonomik i shërbimeve të ujit (dhe mbeturinave) që ka të përcaktuar qartë mandatin dhe përgjegjësitë ligjore.

Për arritjen e këtij synimi do të ndërmirren veprimet vijuese:

(i) Rishikimi i kuadrit ligjor në fushën e rregullimit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave dhe hartimi i propozimeve për harmonizimin e këtij kuadri ligjor;

(ii) Hartimi i draft ligjit për rregullimin ekonomik i cili do të zëvendësonte Ligjin Nr. 03/L-086 me qëllim të përcaktimit më të qartë dhe më të plotë të kornizës rregullatore për shërbimet e ujit;

(iii) Bashkëpunimi me institucionet relevante (Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës) për procedimin amendamentimeve të nevojshme ligjore me qëllim të harmonizimit të kuadrit ligjor dhe krijimit të strukturës institucionale në të cilën janë të përcaktuara qartë rolet dhe përgjegjësitë e akterëve relevant në sektorin e ujit dhe atë të mbeturinave;

(iv) Rishikimi i akteve nënligjore (Rregullave të ZRRUM) në frymën e kuadrit ligjor të amendamentuar dhe në frymën e përvojave të gjertanishme të ZRRUM;

(v) Mbikqyrja e përmbushjes së obligimeve të kompanive të licencuara në pajtim me dispozitat e licencës së shërbimit dhe dispozitat e kuadrit ligjor;

(vi) Faturimi dhe arkëtimi i rregulltë i taksave të licencimit që duhet të paguhen nga kompanitë e rregulluara.

Synimi 2:

Ngritja e profilit të ZRRUM si autoritet i pavarur rregullator që ka kredibilitet dhe participon aktivisht në të gjitha vendimet strategjike për sektorin e ujit dhe mbeturinave në Kosovë.

Për arritjen e këtij synimi do të ndërmirren veprimet vijuese:

(i) Hartimi i propozimeve për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës lidhur me politikat dhe strategjinë e zhvillimit të sektorit të ujit dhe mbeturinave;

(ii) Pjesëmarrja aktive në të gjitha konferencat, takimet punuese dhe workshopet që mbahen për sektorin e ujit dhe mbeturinave;

(iii) Aprovimi i Strategjisë së Komunikimit që adreson komunikimin efektiv të ZRRUM me të gjitha palët e interesit dhe me publikun e gjerë;

(iv) Hartimi dhe publikimi i raporteve dhe hulumtimeve për sektorin e ujit dhe mbeturinave dhe rekomandimi i aktiviteteve për përmirësimin e performancës së këtyre sektorëve;

(v) Njoftimi i plotë dhe me kohë i të gjitha palëve të interesit lidhur me procesin rregullator dhe vendimet e ZRRUM;

(vi) Ngritja e kapaciteteve profesionale të ZRRUM përmes trajnimeve dhe vizitave studimore.

Synimi 3:

Avansimi i sistemit të monitorimit dhe matjes së performancës së kompanive të cilat i rregullon ZRRUM me qëllim të ngritjes së transparencës dhe stimulimit të konkurrencës për shërbimet e ujit dhe mbeturinave.

Për arritjen e këtij synimi do të ndërmirren veprimet vijuese:

(i) Rishikimi i sistemit të vlerësimit të performancës së kompanive të licencuara dhe i indikatorëve kyç të performancës;

(ii) Organizimi dhe realizimi i auditimit të të dhënave të raportuara nga kompanitë e ujit dhe mbeturinave me qëllim të verifikimit të saktësisë së tyre dhe me qëllim të ngritjes së besueshmërisë së tyre;

(iii) Publikimi i Raportit Vjetor të Perfomancës së Kompanive të Ujit dhe Mbeturinave për vitin 2008;

(iv) Ndarja e shpërblimeve për kompanitë e licencuara që kanë demonstruar performancën më të mirë në vitin 2008;

(v) Zhvillimi i takimeve me kompanitë e ujit dhe mbeturinave për të diskutuar rezultatet e Raportit Vjetor të Performancës dhe evitimin e dobësive të identifikuara.

Synimi 4:

Ngritja e nivelit të pajtueshmërisë së kompanive të licencuara me standardet e shërbimit të përcaktuara me kornizën rregullatore.

Për arritjen e këtij synimi do të ndërmirren veprimet vijuese:

(i) Mbajtja e takimeve dhe workshopeve me kompanitë e licencuara për të ngritur njohuritë e tyre me obligimet që dalin nga korniza rregullatore;

(ii) Monitorimi i vazhdueshëm i shkallës së pajtueshmërisë së kompanive të licencuara me kornizën rregullatore dhe komunikimi i rregulltë me Bordet dhe menaxhmentin e kompanive të licencuara;

(iii) Raportimi publik për (mos)pajtueshmërinë e kompanive me kornizën rregullatore;

(iv) Inkurajimi i investimeve nga ana e kompanive të licencuara të cilat janë të nevojshme për arritjen e standardeve të shërbimit të përcaktuara me kornizën rregullatore;

(v) Ndërmarrja e masave sanksionuese në kuadër të autorizimeve ligjore të ZRRUM për rastet e shkeljeve të vazhdueshme të obligimeve ligjore nga ana e kompanive të licencuara.

Synimi 5:

Avansimi i mëtutjeshëm metodologjisë tarifore me qëllim të stimulimit të efiçencës dhe të investimeve kapitale në sektorin e ujit.

Për arritjen e këtij synimi do të ndërmirren veprimet vijuese:

(i) Hartimi i Udhëzimeve për Kompanitë e Ujit lidhur me Kontabilitetin Rregullator (KRR) , Planin e Menaxhimit të Aseteve (PMA) si pjesë integrale të Planit të Biznesit dhe zhvillimi i konsultimeve me palët e interesit;

(ii) Organizimi i takimeve dhe workshopeve me kompanitë e ujit me qëllim të ofrimit të mbështjetjes për implementimin e e tyre KRR dhe PMA;

(iii) Monitorimi i analizimi i shpenzimeve operative dhe kapitale të kompanive të licencuara;

(iv) Monitorimi i zbatimit të Planeve të Investimeve Kapitale të përcaktuara me Planet e Biznesit të Kompanive dhe të aprovuara nga ZRRUM;

(v) Përcaktimi i tarifave të shërbimit për kompanitë regjionale të grumbullimit të mbeturinave, KLMC-në dhe Ibër-Lepencin;

(vi) Përcaktimi i caqeve operative dhe financiare të perfomancës për kompanitë e licencuara në bashkëpunim me Bordet dhe menaxhmentin e tyre dhe sigurimi se këto caqe janë të akceptuara nga të gjithë si kriter për vlerësimin e perfomancës së kompanive;

(vii) Rishikimi dhe korrigjimi eventual për shkallën inflacionit të tarifave për kompanitë regjionale të ujit.

Synimi 6:

Konsolidimi i mekanizmave për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Për arritjen e këtij synimi do të ndërmirren veprimet vijuese:

(i) Zhvillimi i fushatës publike për ngritjen e vetdijes së konsumatorëve me të drejtat dhe obligimet e tyre në lidhje me shërbimet e ujit dhe mbeturinave;

(ii) Fuqizimi i rolit të KKK-ve në trajtimin dhe zgjidhjen efikase të ankesave të konsumatorëve;

(iii) Monitorimi i politikave dhe procedurave të kompanive të licencuara në pajtim me standardet e shërbimit të përcaktuara me kornizën rregullatore;

(iv) Ndërmarrja e masave sanksionuese në kuadër të autorizimeve të ZRRUM në rast të cënimit të të drejtave të konsumatorëve.

Synimi 7:

Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik në Kosovë dhe Europë si dhe me palët tjera të interesit në Kosovë.

Për arritjen e këtij synimi do të ndërmirren veprimet vijuese:

(i) Thellimi i bashkëpunimit me rregullatorët ekonomik të shërbimeve të ujit në vendet e regjionit dhe ato Europiane (WICS, IRAR, ERRU etj);

(ii) Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Entin Rregullator të Ujit të Shqipërisë;

(iii) Inicimi i një bashkëpunimi formal me rregullatorët tjerë ekonomik në Kosovë (ZRRE, ART etj.) për krijimin e një qasje të përbashkët dhe konsistente në zbatimin e rregullimit ekonomik të shërbimeve publike në Kosovë;

(iv) Thellimi i bashkëpunimit me rregullatorët tjerë të sektorit të ujit në Kosovë – IKSHP dhe MMPH-në me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për rregullim efektiv të sektorit të ujit në Kosovë;

(v) Thellimi i relacioneve të mira me palët e interesit të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë si: Qeverinë, Kuvendin e Kosovës, Komunat, Kompanitë e Ujit dhe Mbeturinave, Donatorët, AKMM, SHUKOS, PAMKOS, mediat , komunitetin akademik, shoqërinë civile etj.

6. Aktivitetet e Planifikuara dhe Indikatorët e Matshëm

Synimet Operative	Aktivitetet e Planifikuara	Indikatorët e Matshëm	Departamentet Përgjegjëse	Afatet Kohore
Synimi 1: **Përforcimi i pavarësisë operative dhe financiare të ZRRUM si rregullator i pavarur ekonomik i shërbimeve të ujit (dhe mbeturinave) që ka të përcaktuar qartë mandatin dhe përgjegjësitë ligjore.**	**Rishikimi i kornizës ligjore (Ligjit Nr.03/L-086; Ligjit për Mbeturinat; dhe Ligjit për Ujërat) dhe hartimi i propozimit për harmonizimin e kësaj kornize ligjore**	**Propozimet specifike të ndryshimeve/plotësimeve të ligjeve në fushën e ujërave dhe mbeturinave të kompletuara**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca** • **Drejtori i ZRRUM**	**Janar – Mars 2009**
	Hartimi i Propozimit të Ligjit i cili do të zëvendësonte Ligjin Nr. 3/L-086	**Draft Ligji për rregullimin ekonomik të sektorit të ujit (dhe mbeturinave) i kompletuar**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca** • **Drejtori i ZRRUM**	**Prill 2009**
	Konsultimi me Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës për procedimin e amendamentimeve të nevojshme ligjore me qëllim të harmonizimit të kornizës ligjore në sektorin e ujit dhe mbeturinave	**Amendamentet ligjore të propozuara i janë dorëzuar Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës dhe palëve tjera të interesit si dhe janë mbajtur takime për diskutimin dhe finalizimin e ndryshimeve/plotësimeve të kornizës ligjore**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca** • **Drejtori i ZRRUM**	**Prill– Qershor 2009**
	Rishikimi dhe amendamentimi i Rregullave të ZRRUM	**Të gjitha Rregullat e ZRRUM janë rishikuar dhe sipas nevojës amendamentuar**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca** • **Drejtori i ZRRUM**	**Korrik – Shtator2009**
	Mbikqyrja dhe raportimi për pajtueshmërinë e kompanive me obligimet rregullatore	**Raporti vjetor që pasqyron shkallën e pajtueshmërisë me kornizën rregullatore**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca** • **Drejtori i ZRRUM**	**Janar – Dhjetor 2009**
	Organizimi dhe implementimi i procesit për përtërirjen e licencave të shërbimit për kompanitë e licencuara	**Aplikacionet për përtërirje të licencave janë shqyrtuar dhe licencat e shërbimit janë vazhduar**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca** • **Drejtori i ZRRUM**	**Tetor – Dhjetor 2009**
	Faturimi i rregulltë i taksës së licencimit kompanive të licencuara	**Faturat për taksa të licencimit iu dërgohen rregullisht në fillim të çdo muaji të gjitha kompanive të licencuara**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca**	**Janar – Dhjetor 2009**

Synimi 2: **Ngritja e profilit të ZRRUM si autoritet i pavarur i sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë**	**Hartimi i propozimeve për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës lidhur me politikat dhe strategjitë e zhvillimit të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë**	**Propozimi për politika dhe strategjinë e zhvillimit të sektorit të ujit dhe mbeturinave është hartuar dhe i është dorëzuar Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës**	• **Drejtori i ZRRUM**	**Prill 2009**
	Pjesëmarrja aktive në të gjitha konferencat, takimet e punës dhe workshopet që organizohen për sektorin e ujit dhe mbeturinave	**Në të gjitha konferencat dhe takimet e rëndësishme ku ftohet, ZRRUM merr pjesë aktive dhe kontribuon me idetë dhe sygjerimet e veta.**	• **Drejtori i ZRRUM**	**Janar – Dhjetor 2009**
	Rishikimi i Strategjisë së Komunikimit për ngritjen e transparencës dhe komunikimit efektiv të ZRRUM me palët e interesit dhe publikun e gjerë	**Strategjia aktuale e ZRRUM për komunikim është rishikuar dhe përmirësuar si dhe zbatohet në mënyrë efektive**	• **Zyrtari i RP** • **Drejtori i ZRRUM**	**Janar – Mars 2009**
	Publikimi i raporteve dhe hulumtimeve për sektorin e ujit dhe mbeturinave me rekomandime specifike për veprimet e nevojshme për të ardhmen	**Raportet për performancën e kompanive të licencuara si dhe hulumtimet e kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ujit dhe mbeturinave janë përpiluar, distribuar tek palët e interesit dhe publikuar në web-faqen e ZRRUM**	• **Seksioni për Administratë** • **Drejtori i ZRRUM**	**Janar- Dhjetor 2009**
	Njoftimi i plotë dhe me kohë i të gjitha palëve të interesit lidhur me procesin rregullator dhe vendimet e ZRRUM	• **Organizimi i 2 workshopeve për kontabilitetin rregullator;** • **Organizimi i workshopit për Planin e Menaxhimit të Aseteve** • **Konsultimi me KKK për procesin tarifor** • **Publikimi në web faqe i të gjitha vendimeve të ZRRUM dhe raporteve referuese**	• **Seksioni për Administratë** • **Drejtori i ZRRUM**	**Janar – Dhjetor 2009**
	Ngritja e kapaciteteve profesionale të ZRRUM përmes trajnimeve të stafit dhe vizitave studimore	**Janë mbajtur trajnimet e stafit të ZRRUM sipas planit të paraparë si dhe janë organizuar vizitat studimore tek rregullatorët tjerë**	• **Seksioni për Administratë** • **Drejtori i ZRRUM**	**Janar – Dhjetor 200**

Synimi 3: **Avansimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të perfomancës së kompanive të licencuara**	**Rishikimi i sistemit të vlerësimit të performancës dhe indikatorëve kyç të performancës**	**Janë rishikuar indikatorët kyç të performancës në bazë të cilëve vlerësohet performanca e kompanive të licencuara dhe janë dakorduar ndryshimet adekuate**	• **Seksioni për Performancë** • **Konsultanti i SDC** • **Drejtori i ZRRUM**	**Janar 2009**
	Organizimi dhe realizimi i auditimit të të dhënave financiare, operative, dhe të shërbimeve të konsuamtorëve për të gjitha kompanitë e licencuara	**Janë përpuiluar dhe shpërndarë raportet për auditimet e kryera në të gjitha kompanitë e licencuara**	• **Seksioni për Performancë** • **Konsultanti i SDC**	**Janar–Prill 2009**
	Publikimi i Raportit Vjetor të Performancës së kompanive të ujit dhe mbeturinave për vitin 2008	**Raporti Vjetor për Performancën e KRU-ve dhe KRM-ve është kompletuar, publikuar dhe shpërndarë tek të gjitha palët e interesit**	• **Seksioni për Performancë** • **Konsultanti i SDC** • **Seksioni për Administratë**	**Prill–Qershor 2009**
	Rangimi i kompanive të ujit dhe mbeturinave sipas performansës së demonstruar në vitin 2008 dhe ndarja e shpërblimeve për performansën më të mirë	**Ceremonia e ndarjes së çmimeve është organizuar dhe është dërguar infromacioni për palët e interesit dhe për media**	• **Seksioni për Performancë** • **Konsultanti i SDC** • **Seksioni për Administratë**	**Shtator 2009**
	Zhvillimi i takimeve individuale me kompanitë e ujit dhe mbeturinave për të diskutuar rezultatet e performansës 2008 dhe për ti dakorduar aktivitetet për adresimin e dobësive të identifikuara	**Janë mbajtur takimet individuale me Bordet dhe menaxhmentet e kompanive të ujit dhe mbeturinave dhe janë dakorduar hapat që duhet të ndërmirren për përmirësimin e performansës**	• **Seksioni për Performancë** • **Konsultanti i SDC** • **Drejtori i ZRRUM**	**Shtator–Tetor 2009**
	Analizimi i procesit aktual të monitorimit dhe vlerësimit të performansës, identifikimi i dobësive përgatitja e programit të aktiviteteve për vitin e ardhshëm (2010)	**Programi i aktiviteteve për monitorimin dhe vlerësimin e performansës për vitin 2010 është hartuar dhe iu është shpërndarë kompanive të licencuara dhe palëve tjera të interesit**	• **Seksioni për Performancë** • **Konsultanti i SDC** • **Drejtori i ZRRUM**	**Nëntor–Dhjetor 2009**

Synimi 4: **Ngritja e nivelit të pajtueshmërisë së Kompanive të licencuara me kornizën rregullatore**	**Organizimi dhe mbajtja e takimeve punuese (workshopeve) me kompanitë e ujit dhe mbeturinave për ti diskutuar problemet e pajtueshmërisë me kornizën rregullatore**	**Janë mbajtur 2 workshope dhe poashtu takime individuale (sipas nevojës) me menaxhmentin e të gjitha kompanive të ujit dhe mbeturinave në të cilët janë diskutuar obligimet që dalin nga korniza rregullatore**	• **Seksioni për Performancë** • **Konsultanti i SDC** • **Drejtori i ZRRUM**	**Prill – Korrik 2009**
	Monitorimi i vazhdueshëm i pajtueshmërisë së kompanive të ujit dhe mbeturinave me kornizën rregullatore dhe kushtet e licencës së shërbimit (posedimi dhe zbatimi i procedurave inerne konsistente me kërkesat rregullatore, respektimi i afateve për shqyrtimin e ankesave, niveli i shërbimeve ndaj konsumatorëve etj.)	**Janë ndërmarrë auditimet e rregullta dhe ad-hock sipas nevojës për nivelin e pajtueshmërisë së kompanive me obligimet nga korniza rregullatore**	• **Seksioni për Performancë** • **Seksioni për Ligj dhe Licenca**	**Janar – Dhjetor 2009**
	Raportimi i rregulltë për (mos)pajtueshmërinë e kompanive të ujit dhe mbeturinave me kornizën rregullatore	**Është hartuar raporti vjetor për për nivelin e (mos)pajtueshmërisë së kompanive të ujit dhe mbeturinave me obligimet nga procesi rregullator**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca**	**Dhjetor 2009**
	Ndërmarrja e veprimeve konkrete për ngritjen e shkallës së pajtueshmërisë së kompanive me kornizën rregullatore – duke përfshi edhe sanksionet në kuadër të autorizimeve ligjore për shkeljet e identifikuara	**Janë diskutuar me Bordet dhe menaxhmentet e kompanive lëshimet e konstatuara në përmbushjen e obligimeve që dalin nga procesi rregullator dhe në raste të caktuara janë ndërmarrë edhe masa sanksionuese**	• **Seksioni për Ligj dhe Licenca** • **Drejtori i ZRRUM**	**Janar – Dhjetor 2009**
Synimi 5: ***Avansimi i mëtutjeshëm i***	**Draftimi i Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator (UKRR) për kompanitë e ujit**	**UKRR janë të draftuara dhe u janë dërguar Kompanive të Ujit për komente**	• **Seksioni për Tarifa dhe Financa** • **Drejtori i ZRRUM**	**Prill 2009**
	Finalizimi i Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator dhe	**UKRR janë finalizuar dhe bashkë me kalendarin dhe instrukcionet për**	• **Seksioni për Tarifa dhe Financa**	**Tetor 2009**

metodologjisë tarifore metodologjisë tarifore e cila stimulon efiçencën dhe investimet kapitale	**hartimi i programit për aplikimin e tyre nga ana e Kompanive të Ujit**	**aplikimin e tyre u janë dërguar KRU**	• **Drejtori i ZRRUM**	
	Hartimi i draft Udhëzimeve të Planit për Menaxhimin e Aseteve dhe ofrimi i mbështetjes për kompanitë e ujit për implementimin e tij	**Drafti i Udhëzimeve për PMA është kompletuar**	• **Seksioni për Tarifa dhe Financa** • **Drejtori i ZRRUM**	**Maj 2009**
	Zhvillimi i konsultimeve me Kompanitë e Ujit për diskutimin dhe sqarimin e drafit të Planit të Menaxhimit të Asetever	**Organizmi i 1 workshopi dhe takimeve individuale me KRU-të**	• **Seksioni për Tarifa dhe Financa** • **Drejtori i ZRRUM**	**Maj – Shtator 2009**
	Finalizimi i Udhëzimeve të Planit të Menaxhimit të Asteve dhe hartimi i programit për aplikimin e tyre nga ana e Kompanive të Ujit.	**Udhëzuesit Planit të Menaxhimit të Aseteve janë finalizuar dhe bashkë me kalendarin dhe instrukcionet për aplikimin e tyre u janë dërguar KRU**	• **Seksioni për Tarifa dhe Financa** • **Drejtori i ZRRUM**	**Tetor 2009**
	Krijimi i databazës së aseteve të kompanive dhe sistemit të vlerësimit të gjendjes së asteve për të mundësuar vlerësimin e planeve të investimeve të kompanive nga ana e ZRRUM	**Databaza e aseteve të KRU-ve dhe Ibër -Lepencin është e kompletuar dhe është konsoliduar sistemi për vlerësimin e aseteve dhe planeve investive të kompanive**	• **Seksioni për Tarifa dhe Financa** • **Drejtori i ZRRUM**	**Prill – Dhjetor 2009**
	Rishikimi i tarifave të kompanive të ujit dhe përshtatja e tyre për inflacionin vjetor	**Janë rishikuar dhe korrigjuar tarifat për 7 KRU**	• **Seksioni për Trifa dhe Finaca** • **Drejtori i ZRRUM**	**Tetor – Dhjetor 2009**
	Zhvillimi i procesit tarifor për përcaktimin e tarifave të kompanive të mbeturinave	**Është zhvilluar procesi i përcaktimit të tarifave dhe janë aprovuar tarifat për 7 kompanitë regjionale të mbeturinave si dhe për KLMC-në**	• **Seksioni i Finacave dhe Tarifave** • **Drejtori i ZRRUM**	**Prill – Maj 2009**
	Zhvillimi i procesit tarifor për përcaktimin e tarifave të kompanive të mbeturinave	**Është zhvilluar procesi i përcaktimit të tarifave dhe janë aprovuar tarifat për 7 KRM sidhe për KLMC-në**	• **Seksioni i Finacave dhe Tarifave** • **Drejtori i ZRRUM**	**Tetor – Dhjetor 2009**
Synimi 6:	**Zhvillimi i fushatës për ngritjen e**	**Publikimi dhe shpërndarja e 2**	• **Seksioni për**	**Janar – Qershor 2009**

Konsolidimi i mekanizmave për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve	**vetdijes së konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre në lidhje me shërbimet e ujit dhe mbeturinave**	**broshurave me qëllim të njoftimit të konsumatorëve me të drejtat dhe obligimet e tyre në lidhje me shërbimet e ujit dhe mbeturinave**	**Performancë** • **Analisti i Shërbimeve të Konsumatorëve**	
	Mbajtja e takimeve publike të KKK-ve ku trajtohen ankesat dhe problemet tjera të konsumatorëve	**Për të gjitha takimet e KKK-ve dhe janë të hapura për publikun dhe njoftimi përmes mediave është bërë me kohë para çdo takimi të KKK-ve**	• **Seksioni për Performancë** • **Analisti i Shërbimeve të Konsumatorëve**	**Janar – Dhjetor 2009**
	Sigurimi se kompanitë e licencuara i kanë dhe i zbatojnë procedurat për shërbimet ndaj konsumatorëve në pajtim me standardet e shërbimit të përcaktuara me kornizën rregullatore	**Janë ndërmarrë inspektime për të verifikuar posedimin dhe zbatimin e procedurave të shërbimit ndaj konsumatorëve ashtu siq përcaktohet me kornizën rregullatore**	• **Seksioni për Performancë** • **Analisti i Shërbimeve të Konsumatorëve**	**Janar – Dhjetor 2009**
	Zgjidhja efektive e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe kompanive të ujit ose mbeturinave	**Të gjitha ankesat e konsumatorëve të drejtuara KKK-ve janë shqyrtuar dhe janë zgjidhur**	• **Seksioni për Performancë** • **Analisti i Shërbimeve të Konsumatorëve**	**Janar – Dhjetor 2009**
Synimi 7: ***Ngritja e bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik në Kosovë dhe në Europë dhe me palët tjera të interesit***	**Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Entin Rregullator të Ujit të Shqipërisë**	**Është nënshkruar MiB me ERRU të Shqipërisë**	• **Drejtori i ZRRUM**	**Maj 2009**
	Inicimi i bashkëpunimit formal me rregullatorët tjerë ekonomik në Kosovë si ZRRE, ART etj.	**Është inicuar bashkëpunimi formal me ZRRE, ART etj.**	• **Drejtori i ZRRUM**	**Prill/Maj 2009**
	Thellimi i bashkëpunimit me rregullatorët tjerë të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë (IKSHPK dhe MMPH)	**Janë mbajtur takimet e rregullta dhe janë shkëmbyer informacionet me IKSHPK dhe MMPH**	• **Drejtori i ZRRUM** • **Seksioni për Performancë**	**Janar – Dhjetor 2009**
	Vazhdimi i bashkëpunimit me rregullatorët e ujit në Europë (WICS dhe IRAR) si dhe me palët tjera të interesit në Kosovë	**Mbahen kontakte të rregullta dhe shkëmbehen informacione me interes të ndërsjellë (Raportet e Performancës)**	• **Drejtori i ZRRUM** • **Seksioni për Performancë**	**Janar – Dhjetor 2009**